

UNIVERSITETI “HAXHI ZEKA” - PEJË

SHOQATA ALUMNI - UNHZ



**ANALIZË E PUNËSUESHMËRISË SË TË
DIPLOMUARVE TË UNIVERSITETIT “HAXHI
ZEKA” - PEJË**

Pejë, Shkurt 2023



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET

"HAXHI ZEKA"

Shoqata ALUMNI - UNHZ
Pejë



Analizë e Punësueshmërisë së të Diplomuarve të Universitetit "Haxhi Zeka" - Pejë

Autorë:

MSc. Rozafa Hajdari

MSc. Njomza Jupa

Ekipi Punues:

PhD (c). Abedin Selimaj - Drejtor i Zyrës për Zhvillimin e Karrierës, Universiteti "Haxhi Zeka" -Pejë

BSc. Nora Draga - Drejtoreshë e Shoqatës ALUMNI - UNHZ

MSc. Rozafa Hajdari - E diplomuar në Universitetin "Haxhi Zeka" - Pejë (ALUMNI - UNHZ)

MSc. Njomza Jupa - E diplomuar në Universitetin "Haxhi Zeka" - Pejë (ALUMNI - UNHZ)

BSc. Artur Morina - Student në Universitetin "Haxhi Zeka" - Pejë

BSc. Leart Berisha - Student në Universitetin "Haxhi Zeka" - Pejë

Sihana Mustafa - Studente në Universitetin "Haxhi Zeka" - Pejë

Pejë, Shkurt 2023



Përmbajtja

Lista e tabelave.....	4
Lista e figurave	4
Lista e grafikëve	4
Lista e shkurtesave	5
Përmbledhje Ekzekutive.....	6
1. UNIVERSITETI "HAXHI ZEKA" - PEJË SI INSTITUCION I ARSIMIT TË LARTË	7
1.1. Zyra për Zhvillimin e Karrierës.....	9
1.2. Shoqata ALUMNI - UNHZ	11
2. METODOLOGJIA E STUDIMIT.....	13
3. FAZA E REALIZIMIT TË STUDIMIT	16
4. REZULTATET, TË GJETURAT DHE DISKUTIMI	18
5. KONKLUZIONET DHE REKOMANDIMET	39
Referencat.....	42
SHTOJCË.....	43



Lista e tabelave

Tabela 1. Aktivitetet e fazës së realizimit të studimit	17
Tabela 2. Gjinia e respondentëve.....	18
Tabela 3. Vendbanimet e respondentëve	19
Tabela 4. Fakultetet në të cilat kanë ndjekur studimet respondentët	20
Tabela 5. Departamentet në të cilat kanë ndjekur studimet respondentët	22
Tabela 6. Niveli i studimeve të respondentëve	24
Tabela 7. Vitet e diplomimit të respondentëve	25
Tabela 8. Niveli i punësimit të respondentëve	26
Tabela 9. Niveli i vetëpunësimit të respondentëve	26
Tabela 10. Kryqëzimi i tabelave të nivelit të punësimit dhe të vetëpunësimit i respondentëve.....	27
Tabela 11. Niveli i punësimit sipas nivelit të shkollimit.....	27
Tabela 12. Niveli i punësimit sipas llojit të sektorit	28
Tabela 13. Statusi i punësimit sipas kategorive	28
Tabela 14. Kategoritë e institucioneve dhe bizneseve ku janë të punësuar të diplomuarit e UHZ-së	29
Tabela 15. Kategoritë e bizneseve ku janë vetëpunësuar të diplomuarit e UHZ-së.....	33
Tabela 16. Rolet apo pozitat që kanë të diplomuarit e UHZ-së në vendet e tyre të punës.....	34
Tabela 17. Sa iu kanë shërbyer njohuritë e fituara gjatë studimeve në punën tuaj?	37

Lista e figurave

Figura 1. Fazat e zhvillimit të studimit	15
Figura 2. Grafiku Gantt (Gantt Chart)	16
Figura 3. Grafiku PERT (PERT Chart)	17

Lista e grafikëve

Grafiku 1. Gjinia e respondentëve	18
Grafiku 2. Vendbanimet e respondentëve.....	20
Grafiku 3. Fakultetet në të cilat kanë ndjekur studimet respondentët	21
Grafiku 4. Departamentet në të cilat kanë ndjekur studimet respondentët	23
Grafiku 5. Niveli i studimeve të respondentëve.....	24
Grafiku 6. Vitet e diplomimit të respondentëve.....	25
Grafiku 7. Niveli i punësimit dhe i vetëpunësimit të respondentëve	26
Grafiku 8. Kategoritë e institucioneve dhe bizneseve ku janë të punësuar të diplomuarit e UHZ-së	30
Grafiku 9. Kategoritë e bizneseve ku janë vetëpunësuar të diplomuarit e UHZ-së	33
Grafiku 10. Rolet apo pozitat që kanë të diplomuarit e UHZ-së në vendet e tyre të punës	35
Grafiku 11. Sa iu kanë shërbyer njohuritë e fituara gjatë studimeve në punën tuaj?	38



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET

"HAXHI ZEKA"

Shoqata ALUMNI - UNHZ
Pejë



Lista e shkurtesave

AKA	Agjencia e Kosovës për Akreditim
ALUMNI - UNHZ	ALUMNI I UNIVERSITETIT "HAXHI ZEKA" - PEJË
FA	Fakulteti i Arteve
FAB	Fakulteti i Agrobiznesit
FB	Fakulteti i Biznesit
FJ	Fakulteti Juridik
FMTM	Fakulteti i Menaxhimit në Turizëm, Hoteleri dhe Mjedis
FSHAB	Fakultetin e Shkencave të Aplikuara në Biznes
IAL	Institucion i Arsimit të Lartë
OJQ	Organizatë Joqeveritare
UHZ	Universiteti "Haxhi Zeka"
UP	Universitetit të Prishtinës
ZZHK	Zyra për Zhvillim të Karrierës



Përmbledhje Ekzekutive

Universiteti "Haxhi Zeka" - Pejë (UHZ) është Institucion i Arsimit të Lartë (IAL) i themeluar para 11 vjetëve, në kuadër të cilin funksionojnë pesë (5) fakultete dhe pesëmbëdhjetë (15) programe të studimit me specializimet përkatëse. IAL-të si qëllim kryesor kanë përgatitjen e kuadrove të reja dhe profesionale të cilët do t'i shërbejnë vendit dhe tregut të punës. Lidhur me këtë çështje, Zyra e Karrierës, e cila funksionon në kuadër të UHZ-së, në bashkëpunim me Shoqatën e të diplomuarve ALUMNI - UNHZ kanë ndërmarrë realizimin e këtij studimi përmes të cilit është bërë një analizë e punësueshmërisë së të diplomuarve të UHZ-së. Me këtë UHZ ka dashur të vlerësoj punën e vet dhe të shoh se a po i përmbush objektivat e vendosura që përmenden në fjalën e Rektorit:

"Universiteti është mundësia më e mirë që mund t'u ofrohet të rinjve dhe të rejave tona për të marrë formim të mirëfilltë. Ai ua jep mundësinë për ta ndërtuar të ardhmen e tyre. Qëllimi dhe orientimi ynë kryesor janë studentët, formimi i tyre, në mënyrë që ata të jenë të dobishëm për veten, për familjet e tyre dhe për vendin e tyre. Vetëm duke ua ofruar atyre mundësinë e arsimit hapim rrugën për zhvillim dhe prosperitet të vendit tonë. Përpyekjet tona do të përqendrohen në ngritjen e cilësisë, ofrimin e programeve të përputhshme me nevojat e tregut, si dhe ofrimin e shkathtësive plotësuese, të cilat studentët tanë i bëjnë konkurrentë në tregun e dijes dhe të punës. Synim ynë i përhershëm mbetet që të nxjerrim kuadro të cilët do të punojnë në përmirësimin e jetës së qytetarëve tanë e që do të na bëjnë krenarë me arritjet e tyre shkencore e profesionale edhe jashtë vendit. Bashkëpunimi me institucionet e arsimit të lartë, qofshin ato vendëse ose ndërkombëtare, do të shfrytëzohet në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm të mësimdhënies dhe mësimnxënies. Mobiliteti i stafit akademik dhe i studentëve, shkëmbimi i përvojave dhe i metodave, do të sjellë përvoja, kulturë dhe frymë të re në institucionin tonë, duke përmirësuar ndjeshëm jetën akademike dhe atë studentore. Gjithashtu, ne do të punojmë ngushtë me palët e interesit, shoqërinë civile, bizneset, institucionet publike dhe private, ngase bashkëpunimi me ta është thelbësor për orientimin e programeve të universitetit tonë drejt nevojave të tregut. Sfidat për arritjen e objektivave tona sigurisht që janë të mëdha, por ëndrrat për ta shndërruar universitetin në një universitet bashkëkohor janë edhe me të mëdha. Prandaj, secili nga ne veç e veç, në pozitën e tij, është i rëndësishëm për arritjen e këtyre qëllimeve. Të gjithë bashkë, ndërkaq, mund ta bëjmë realitet këtë ëndërr të përbashkët. Është detyrë dhe obligim ynë që të mbajmë lart frymën e bashkëpunimit dhe të shpirtit qytetar të vendit tonë" (Fjala e Rektorit Prof. Dr. Armand Krasniqi).



1. UNIVERSITETI “HAXHI ZEKA” - PEJË SI INSTITUCION I ARSIMIT TË LARTË

Peja është një është ndër qendrat e para në Kosovë në fushën e ofrimit të arsimit të lartë. Ish-Shkolla e Lartë Komerciale, e transformuar pas vitit 1999 në Fakultetin e Shkencave të Aplikuara në Biznes (FSHAB), është themeluar qysh në vitin 1960, duke kontribuar në krijimin dhe promovimin e një kulture akademike. Pas vitit 1999, themelimi i FSHAB-it, jo vetëm që paraqet një epokë të rëndësishme historike arsimore, por vlerësohet si një etapë e re zhvillimi mbi bazat e Deklaratës së Bolonjës. Fillimi i transformimit akademik të arsimit të lartë në Kosovë drejt parimeve të Bolonjës ka qenë thelbësor e epokal për ish FSHAB-in në Pejë, i cili në atë kohë funksiononte në kuadër të Universitetit të Prishtinës (UP). Vlera e këtij institucioni rritet edhe me diversitetin gjuhësor, etnik dhe kulturor. Programet mësimore janë zhvilluar në gjuhën shqipe dhe serbo-kroate nga profesorë të nacionaliteteve të ndryshme (UHZ, 2023).

Universiteti “Haxhi Zeka”, me seli në Pejë, është themeluar në bazë të vendimit nr. 434/01 B të Ministrit të Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë të datës 14.11.2011 (UHZ, 2013). Pas një faze përgatitore, fillimi i procesit mësimor mban datën 01.10.2012. Në këtë periudhë kohore universiteti së bashku me pesë (5) njësitë akademike për herë të parë i janë nënshtruar procesit të vlerësimit dhe akreditimit nga Agjencia e Kosovës për Akreditim (AKA) (UHZ, 2023).

Pesë (5) njësitë akademike (fakultetet) që funksionojnë në kuadër të Universitetit “Haxhi Zeka” janë:

- (1) Fakulteti i Biznesit (FB),
- (2) Fakulteti Juridik (FJ),
- (3) Fakulteti i Menaxhimit në Turizëm, Hoteleri dhe Mjedis (FMTHM),
- (4) Fakulteti i Agrobiznesit (FAB) dhe
- (5) Fakulteti i Arteve (FA).

Çdo entitet, qoftë institucion, organizatë apo biznes, duhet të deklarojë misionin, vizionin dhe vlerat e veta. Misioni nënkupton arsyen pse ekziston një entitet (Certo & Certo, 2016), pra paraqet një deklaratë të qëllimit të ekzistencës së atij entiteti (David & David, 2017; Robbins & Coulter, 2018). Vizioni ka të bëjë me aspiratat e një entiteti dhe përshkruan atë që ai entitet dëshiron të arrijë (Rothaermel, 2017). Vlerat paraqesin deklaratatë të parimeve për të udhëhequr një entitet përderisa ai punon dhe angazhohet



për të përmbushur misionin dhe arritur vizionin, si për sjelljen e brendshme ashtu edhe për ndërveprimet e jashtme, të cilat përfshijë konsiderata të qarta etike (Rothaermel, 2017). Në këtë drejtim, misioni, vizioni dhe vlerat e Universitetit "Haxhi Zeka" - Pejë, si Institucion i Arsimit të Lartë, janë si vijon:

Misioni: *Universiteti "Haxhi Zeka" si institucion akademik transferon dije në funksion të realizimit të potencialit të studentëve drejt tregut dinamik të punës, i përkushtuar në hulumtime shkencore, veprimtari artistike dhe ndërkombëtarizim, për t'i shërbyer zhvillimit ekonomik të rajonit të Pejës dhe të vendit në përgjithësi.*

Vizioni: *Universiteti "Haxhi Zeka" lider me kurrikulë studimore të integruar dhe bashkëkohore në harmoni me kërkesat e tregut në fushën e biznesit, agrobiznesit, mjedisit, turizmit, arteve, drejtësisë, aplikimit të teknologjisë së informacionit dhe në fusha të tjera të ndërlidhura.*

Vlerat: *Në funksion të përmbushjes së vizionit dhe misionit të vet, Universiteti "Haxhi Zeka" do të udhëhiqet nga vlerat dhe përgjegjësitë e mëposhtme:*

- **Integriteti profesional dhe akademik** - Të hapur dhe të sinqertë në veprimet tona;
- **Gjithëpërfshirja dhe barazia** - Vlerësojmë diversitetin, përfshirjen, kujdesin, respektin dhe mirëpresim gjithsecilin;
- **Liria e shprehjes dhe e të menduarit** - Inkurajojmë dhe vlerësojmë lirinë e shprehjes dhe mendimin kritik akademik;
- **Konkurrueshmëria** - Dëshira dhe motivimi për t'u bërë më të suksesshëm dhe më të dallueshëm;
- **Shërbimi ndaj komunitetit** - Bashkëpunim me grupe të interesit për t'ju përgjigjur sa më mirë nevojave të tyre.



1.1. Zyra për Zhvillimin e Karrierës

Shërbimet e karrierës janë shumë më tepër se sa shkrimi i CV-ve dhe kërkimi për praktika ose punë me kohë të plotë. Profesionistët e shërbimeve të karrierës inkurajohen të kërkojnë mundësi për të rritur ndërgjegjësimin për përfitimet e shërbimeve që ofrojnë zyrat për zhvillimin e karrierës (Makela et al., 2014). Shërbimet e karrierës janë një pjesë kyçe e programeve që synojnë rekrutimin dhe mbajtjen e studentëve të diplomuar në një mjedis në të cilin IAL-të duhet të jenë proaktive në përgatitjen e studentëve të diplomuar për kalimin drejt angazhimit në karrierë (Polson, 2003; Song, 2007). Suksesi në ofrimin e shërbimeve të karrierës nuk është çështje që shqetëson vetëm studentët, por është një faktor kritik në perceptimin e publikut për suksesin e institucioneve arsimore, në tërësi (Song, 2007).

Me objektivin kryesor orientimin dhe këshillimin e studentëve për qasje sa më të mirë në tregun e punës në kuadër të UHZ-së funksionon Zyra për Zhvillim të Karrierës (ZZHK).

Misioni i ZZHK: *Informimi, mbështetja dhe inkurajimi i studentëve në ndërtimin e potencialit të tyre të plotë për ta shfrytëzuar siç duhet dhe për të pasur një karrierë të suksesshme. ZZHK synon që të ndihmojë studentët që të kalojnë me sukses fazën e kalimit nga niveli akademik në fazën e ushtrimit të profesionit në praktikë, përmes të ofruarit të shërbimeve më të mira konsultative për sa u përket nevojave të tregut të punës, pritjeve të punëdhënësve, aftësive punuese, trendeve të kualifikimit, zhvillimit të karrierës, etj.*

ZZHK ka kapacitete për ta zgjeruar më tej rolin e saj, në mënyrë që të shërbej si urë lidhëse midis studentëve dhe tregut të punës. Me qëllim promovimin e studentëve të UHZ-së dhe kërkimin e mundësive të reja të punësimit, kjo zyrë krijon dhe mirëmban kontaktet e duhura me punëdhënësit potencialë. Deri më tani, ZZHK e zhvillon aktivitetin e vet nëpërmjet pjesëmarrjes në panairë të punës dhe në ngjarje të ngjashme. Po ashtu, ZZHK është duke u angazhuar në certifikimin e zyrtarëve të karrierës në fushat përkatëse. Aktiviteti i saj është orientuar edhe në krijimin e një rrjeti me zyrat e karrierës të universiteteve të tjera. Në mënyrë të veçantë, është duke u studiuar mundësia e rrjetëzimit të saj me zyrat e karrierës së shkollave të mesme, të cilat kanë programe të ngjashme me ato që i ofron UHZ-ja (UHZ, 2023).



Shërbimet kryesore të ZZHK-së përfshijnë:

- Ndhimën për studentët që të planifikojnë, identifikojnë dhe realizojnë qëllimet e karrierës dhe hulumtimet për punë;
- Ofrimin e informacionit aktual mbi mundësitë e punësimit dhe të punës praktike (intership);
- Ofrimin e informatave mbi studimet jashtë vendit, shkollat verore, trajnimet, panairët të karrierës dhe të ngjashme;
- Ofrimin e informatave aktuale mbi gjendjen e tregut të punës;
- Organizimin dhe informimin për ngjarje që iu mundësojnë studentëve krijimin e rrjeteve, intervistave dhe njoftimeve me punëdhënës;
- Promovimin dhe mbajtjen afatgjatë dhe të vazhdueshme të kontakteve dhe zhvillimin e partneritetit me qendra akademike dhe zyrat e karrierës për të siguruar shkëmbime cilësore mes zyrës së karrierës, komunitetit akademik dhe punëdhënësve brenda dhe jashtë Kosovës.

Për studentët e UHZ-së, ZZHK ofron trajnime për mënyrat e përgatitjes së CV-së, letrës motivuese, këshilla për intervistë pune, informata rreth mënyrave të qasjes ndaj tregut të punës, trajnime për zhvillimin e shkathtësive që kërkon tregu i punës, etj. Kjo zyrë bënë informimin e studentëve për aktivitete të ndryshme përmes internetit (e-mailit, web faqes dhe platformës E-Praktika). Të diplomuarit në UHZ, kanë mundësi që përmes ZZHK-së të informohen për mundësi të ndryshme punësimi, të marrin pjesë në takime të ndryshme me punëdhënës, të kontaktojnë më lehtë me punëdhënësit, të informohen për mundësi të ndryshme studimi jashtë vendit, të njoftohen për konferenca, seminare, punësime sezonale, shkolla verore që ofrohen për ta dhe të ngjashme.

Për punëdhënësit që janë të interesuar për punësimin e studentëve dhe të diplomuarve, ZZHK ofron:

- Shpalljen e njoftimeve për vende të lira të punës, punëve me orar të shkurtuar dhe praktikës për studentë;
- Promovimin e kulturës së punës dhe vlerave profesionale të kompanisë;
- Ndërlidhjen me studentët dhe të diplomuarit e UHZ-së;
- Mundësi për rekrutim më të lehtë të stafit të trajnuar në ZZHK;
- Pjesëmarrje në punëtori dhe tryeza të rrumbullakëta me tema të ndryshme diskutimi dhe të ngjashme.



1.2. Shoqata ALUMNI - UNHZ

ALUMNI I UNIVERSITETIT "HAXHI ZEKA" - PEJË (ALUMNI - UNHZ) është Organizatë Joqeveritare (OJQ) e regjistruar në bazë të nenit 22 Ligjit Nr. 06/L-043 për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare në Republikën e Kosovës.

Të dhënat për shoqatën ALUMNI - UNHZ janë:

Emri i plotë:	<i>ALUMNI I UNIVERSITETIT "HAXHI ZEKA" - PEJË</i>
Shkurtesa:	<i>ALUMNI - UNHZ</i>
Nr. i Regjistrimit:	<i>5118589-7</i>
Data e Regjistrimit:	<i>19.08.2020</i>
Numri Fiskal:	<i>602381741</i>

Shoqata ALUMNI - UNHZ është themeluar me iniciativë të një grupi të të diplomuarve të UHZ-së me mbështetjen e ZZHK-së me qëllim që të mbledh rreth vetes të diplomuarit në nivelin bachelor dhe master, si dhe të forcoj marrëdhëniet ndërmjet UHZ-së dhe të diplomuarve të tij. ALUMNI - UNHZ përkushtohet t'i shërbej Universitetit, të diplomuarve dhe studentëve.

Misioni i ALUMNI - UNHZ:	<i>Të forcoj dhe zhvilloj UHZ-në nëpërmjet asistimit në rekrutimin e studentëve, angazhimin në aktivitete për të rritur reputacionin e Universitetit në vend dhe jashtë, si dhe të promovoj imazhin pozitiv të Universitetit dhe të diplomuarve.</i>
---------------------------------	--

Objektivat e Shoqatës ALUMNI - UNHZ janë:

- Lidhja e gjeneratave të studentëve, për të krijuar bashkëpunim të vazhdueshëm dhe krijimi i lidhjeve në mes të diplomuarve, profesorëve të fakulteteve përkatëse dhe bashkësisë më të gjerë akademike;
- Promovimi i ekzistencës, punës dhe domethënies së Shoqatës ALUMNI - UNHZ;
- Krijimi i bazës së të dhënave të të diplomuarve të UHZ-së për të bërë të mundur depërtimin e tyre në tregun e punës;
- Organizimi i trajnimeve, seminareve, konferencave profesionale dhe ngjarjeve të ngjashme dhe të kontributi në avancimin profesional të të diplomuarve;
- Përforcimi i reputacionit të Universitetit me ngritjen e reputacionit të të diplomuarve;



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET

"HAXHI ZEKA"

Shoqata ALUMNI - UNHZ
Pejë



- Zhvillimi i bashkëpunimit të Universitetit me ndërmarrje dhe institucione në të cilat janë të angazhuar të diplomuarit e UHZ-së;
- Pjesëmarrja në shkëmbimin shkencor dhe profesional ndërkombëtar përmes vendosjes së relacioneve me Shoqatat ALUMNI të regjionit dhe më gjerë;
- Avancimi i shkathtësive akademike sipas kërkesave të tregut.

Aktivitetet e Shoqatës ALUMNI - UNHZ mund të përmbliidhen si vijon:

- Organizimi i tryezave të rrumbullakëta, trajnimeve, seminareve dhe konferencave në të cilat do të trajtohen çështje me interes;
- Organizimi i programeve për aftësim dhe trajnim të anëtarëve të Shoqatës ALUMNI - UNHZ në kontekstin e informimit më të mirë për trendet zhvillimore dhe kërkesat e tregut;
- Organizimi i takimeve të anëtarëve të Shoqatës ALUMNI - UNHZ me studentët aktualë, për t'ua përcjellë përvojat e tyre;
- Bashkëpunimi me ZZHK ashtu që anëtarët e Shoqatës ALUMNI - UNHZ të kenë qasje në informacione dhe në mundësitë për trajnime të mëtejme, si dhe në aplikime në pozita të cilat iu përgjigjen më shumë kualifikimeve dhe aftësive të tyre.

Theksojmë se për të gjithë të interesuarit për të qenë anëtarë të Shoqatës ALUMNI - UNHZ ofrohet mundësia e aplikimit online në web faqen zyrtare të UHZ-së.



2. METODOLOGJIA E STUDIMIT

Ne jetojmë në një shoqëri informacioni ku ekziston një kërkesë gjithnjë në rritje për informacion statistikor të natyrës ekonomike, sociale, politike dhe kulturore. Një informacion i tillë do t'u mundësoj politikëbërësve dhe të tjerëve të marrin vendime të informuara për një të ardhme më të mirë (Bethlehem, 2009). Duke u nisur nga ky parim, se ekziston një kërkesë gjithnjë në rritje për informacion statistikor përkatës dhe nga nevoja për të pasur të dokumentuar çështjen e punësimit të të diplomuarve të UHZ-së, u ndërmor realizimi i një studimi i cili si rezultat të vetin sjell raportin e shkruar nga analiza e punësueshmërisë së të diplomuarve të UHZ-së.

Metodologjia e studimit bazohet në një qasje mikse, e cila ka bërë të mundur që të përmbushet qëllimi i studimit. Kjo qasje u bazua në shqyrtimin e informacioneve nga burimet ekzistuese, si dhe në informacionet e reja të fituara pas analizave të kryera. Në lidhje me këtë Bethlehem (2009) shprehet se, informacioni statistikor mund të merret nga burimet ekzistuese, por më shpesh, ka mungesë të burimeve të tilla dhe për këtë arsye duhet të mbledhen informacione të reja statistikore.

Studimi i realizuar ka kaluar nëpër disa faza (shih Figura 1). Fillimisht është bërë përkufizimi i problemit se çfarë është e nevojshme të bëhet dhe më pas janë përcaktuar objektivat e studimit me qëllim që puna të realizohet më me efektivitet. Kur u bë e qartë se UHZ-së i nevojitet një raport me të gjeturat lidhur me punësueshmërinë e të diplomuarve të vetë, atëherë në konsultim me ZZHK-në u analizuan informacionet ekzistuese dhe aktivitetet që ishin realizuar në periudhën e mëhershme para fillimit të këtij studimi. Kështu, u analizuan pyetëtori që deri atëherë ishte aktiv dhe përmes të cilit ishte gjeneruar databaza ekzistuese me të dhënat e të diplomuarve të UHZ-së. Me qëllim të shtimit të efektivitetit dhe përmbushjes së qëllimit të studimit, duke u bazuar në pyetëtorit paraprak, është përpiluar pyetëtori i ri, i cili u përdor si instrument për mbledhjen e të dhënave primare. Menjëherë pas përpilimit të pyetëtorit filloi procesi i anketimit. Mostër e studimit ishin 1002 të diplomuar të UHZ-së. Kjo mostër ishte e qëllimshme. Anketimi i krye me qasjen online dhe ballë për ballë (face-to-face). Nga databaza ekzistuese u mor lista e email-ave të të diplomuarve të UHZ-së të cilëve iu shpërnda pyetëtori online. Gjithsej u dërguan rreth 1000 emaila, si dhe nga ekipi punues u bë anketimi në terren nëpër institucione dhe biznese të ndryshme në Komunën e Pejës, Klinës, Istogut, Deçanit, si qendra më të mëdha nga ku vijnë studentët e UHZ-së. Nga puna në terren u shpërndanë, po ashtu, rreth 1000 pyetësor. Anketimi në terren dhe Anketimi online siguruan marrjen e përgjigjeve në 802, ndërsa 200




pyetësor të tjerë janë marrë nga databaza ekzistuese, të cilët ishin plotësuar gjatë vitit 2022, pra ishin të dhëna të reja.

Pas analizimit dhe përmirësimit të databazës ekzistuese dhe gjatë procesit të anketimit, u krijua databaza e re e cila çdo ditë plotësohej me informacione dhe të dhëna të reja. Procesi i anketimit ishte aktivitet që e përcjelli studimin deri në javën e fundit. Gjatë kohës së anketimit një pjesë e ekipit punues u morën me shqyrtim të burimeve të informacionit dhe të dhënave të UHZ-së, siç janë: Plani Strategjik 2023-2026, Statuti i Universitetit "Haxhi Zeka" dhe burime të tjera me interes për studimin, si dhe janë shqyrtuar dhe analizuar burime të jashtme, përfshirë raportet e ASK-së dhe literatura e huaj që ndërlidhej me studimin e realizuar.

Anketimi zgjati 14 ditë, periudhë kjo gjatë së cilës u krye punë efektive dhe e pandërprerë, dhe për të realizuar studimin në tërësi u punua 21 ditë me orar të zgjatur. Konceptet me interes për studimin dhe që i shërbenin përpilimit të këtij raporti u përblodhën në të njëjtën linjë sa punohej në databazë re. Pra, shkrimi i raportit ka filluar gjatë kohës kur kryhej anketimi. Me përfundimin e periudhës së anketimit, filloi nxjerrja e rezultateve. Për këtë qëllim, kanë shërbyer Microsoft Excel dhe SPSS (Statistical Package for Social Sciences - Paketa Statistikore për Shkencat Sociale). Rezultatet e dalave janë analizuar dhe përpunuar nga autorët, janë paraqitur në formë tabelare dhe grafike, si dhe janë interpretuar të gjeturat. Gjithashtu, të gjeturat nga ky studim janë krahasuar me rezultatet e publikuara nga ASK-ja lidhur me nivelin e punësimit në përgjithësi.

Në fund, bazuar në rezultatet e tërësishme dhe në komentet e marra nga respondentët, respektivisht nga të diplomuarit e UHZ-së është bërë një përmbledhje e vlefshme nga ku janë dhënë edhe rekomandimet lidhur me atë se në çfarë duhet orientohet përmirësimi i vazhdueshëm i punës së UHZ-së. Për të parë metodologjinë e këtij studimi në formë të përmbledhur referojuni Figurës 1.

Figura 1. Fazat e zhvillimit të studimit



Burimi: Autorët (2023)



3. FAZA E REALIZIMIT TË STUDIMIT

Kjo pjesë përmbledh përmes grafikut Gantt dhe grafikut PERT (Program Evaluation Review Technique - Teknika e Rishikimit të Vlerësimit të Programit) tërë fazën e realizimit të studimit. Grafiku Gantt është një lloj grafiku që tregon informacione të tilla si aktivitetet, datat e fillimit dhe mbarimit, kohëzgjatja dhe lidhja midis aktiviteteve (EU, 2021). Në grafikun Gantt (shih Figura 2), paraqiten të gjitha aktivitetet që janë realizuar gjatë 21 ditëve të punës, si dhe shihen aktivitetet e lidhura me njëra-tjetrën, pra aktivitetet që janë realizuar në të njëjtën kohë.

Figura 2. Grafiku Gantt (Gantt Chart)

Gant Chart	Muaji	Janar						Shkurt														
	Java	Java 1					Java 2					Java 3					Java 4					
	Data	23	24	25	26	27	30	31	1	2	3	6	7	8	9	10	13	14	15	16	20	21
1 Aktivitetet sipas ditëve	Dita	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18	19	20	21
1 Diskutimi i idesë së studimit																						
1.1 Përkufizimi i problemit																						
1.2 Përcaktimi i objektivave																						
2 Instrumenti i hulumtimit																						
2.1 Analizimi i pyetësorit ekzistues																						
2.2 Përpilimi i pyetësorit të ri																						
2.3 Periudha e anketimit																						
3 Baza e të dhënave																						
3.1 Analizimi dhe përmirësimi i databazës ekzistuese																						
3.2 Krijimi i databazës së re																						
4 Shqyrtimi i burimeve të informacionit dhe të dhënave relevante																						
4.1 Shqyrtimi i burimeve të UHZ-së																						
4.2 Shqyrtimi i burimeve të ASK-së																						
4.3 Shqyrtimi i burimeve të huaja																						
5 Përgatitja e dokumentit të shkruar																						
5.1 Përmbledhja e koncepteve dhe çështjeve me interes për studimin																						
5.2 Performimi i analizave dhe nxjerrja e rezultateve																						
5.3 Nxjerrja e konkluzioneve dhe dhënia e rekomandimeve																						
5.4 Finalizimi i dokumentit të shkruar																						
6 Dorëzimi i dokumentit tek institucioni																						

Burimi: Autorët (2023)

Bazuar në paket punuese, ku përfshihen aktivitetet përkatëse, në Tabelën 1 janë paraqitur aktivitetet të cilat kanë shërbyer për përpilimin e grafikut PERT. Grafiku PERT jep paraqitjen grafike të afatit kohor të një projekti që shfaq të gjitha detyrat individuale të nevojshme për të përfunduar projektin. Përmes këtij grafiku vlerësohen kohën dhe burimet e nevojshme për të menaxhuar një projekt


(Kopp, 2022). Grafiku PERT (shih Figura 3) i paraqet në mënyrë të qartë dhe të detajuar aktivitetet e lidhura me kohën, ku shihet se studimi përmbillet në ditën 21.

Tabela 1. Aktivitetet e fazës së realizimit të studimit

Përshkrimi i Aktivitetit	Aktiviteti (simboli)	Aktiviteti/et Parardhës/e	Kohëzgjatja e Aktivitetit (në ditë)
Përkufizimi i problemit	A	0	1
Përcaktimi i objektivave	B	A	1
Përpilimi i pyetësorit	C	B	1
Periudha e anketimit	D	C	14
Krijimi i databazës	E	C	12
Shqyrtimi i burimeve relevante	F	C	4
Përgatitja e dokumentit të shkruar	G	D, E, F	3
Dorëzimi i dokumentit tek institucioni	H	G	1

Burimi: Autorët (2023)

Figura 3. Grafiku PERT (PERT Chart)



Burimi: Autorët (2023)



4. REZULTATET, TË GJETURAT DHE DISKUTIMI


Në këtë pjesë paraqiten rezultatet dhe të gjeturat nga analiza e punësueshmërisë së të diplomuarve të UHZ-së. Rezultatet e përpunuara janë paraqitur në formë tabelare dhe grafike nga ku mund të shihen të gjënat demografike të respondentëve si: gjinia dhe vendbanimi, të dhënat lidhur me studimet e tyre si: fakulteti dhe departamenti ku kanë ndjekur studimet, niveli i studimeve dhe viti i diplomimit, si dhe të dhënat për punësimin e tyre si: statusi i punësimit, institucioni/biznesi ku ata janë të punësuar apo të vetëpunësuar, viti i punësimit, roli apo pozita që ata kanë në vendin përkatës të punës dhe aspekti se sa iu kanë shërbyer njohuritë e fituara nga studimet në punën e tyre.

Rezultatet e dalta janë interpretuar dhe krahasuar edhe me statistika relevante në mënyrë që të pasurohet diskutimi dhe të analizohet më në detaje çështja e punësimit të popullsisë në Kosovë në përgjithësi dhe të të diplomuarve të UHZ-së në veçanti.

Tabela 2. Gjinia e respondentëve

Gjinia	Frekuenca	Përqindja	Përqindja Valide	Përqindja Kumulative
M	368	36.7	36.7	36.7
F	634	63.3	63.3	100.0
Totali	1002	100.0	100.0	

Grafiku 1. Gjinia e respondentëve






Në Tabelën 2 dhe Grafikon 1 paraqiten rezultatet lidhur me gjininë e respondentëve, nga ku shihet se 36.7% (ose në numra nominal 368 persona) e respondentëve ishin të gjinisë mashkullore dhe 63.6% (ose në numra nominal 634 persona) ishin të gjinisë femërore.

Tabela 3. Vendbanimet e respondentëve

Vendbanimi	Frekuenca	Përqindja
Në Kosovë		
Deçan	122	12.2
Dragash	1	0.1
Drenas	1	0.1
Fushë Kosovë	4	0.4
Gjakovë	67	6.7
Gjilan	2	0.2
Istog	102	10.2
Junik	14	1.4
Klinë	63	6.3
Malishevë	1	0.1
Obiliq	1	0.1
Pejë	589	58.8
Prishtinë	13	1.3
Prizren	4	0.4
Shtime	1	0.1
Skënderaj	2	0.2
Mungojnë të dhënat	4	0.4
Totali	991	98.9
Vendbanime të tjera (jashtë Kosovës)		
Gjermani	2	0.2
Hanover	3	0.3
München	1	0.1
New York	2	0.2
Stuttgart	1	0.1
Suedi	2	0.2
Totali	11	1.1
Totali i përgjithshëm	1002	100.0

Grafiku 2. Vendbanimet e respondentëve




Vendbanimet e respondentëve paraqiten në Tabelën 3 dhe Grafikon 2. Nga këtu shihet se 12.2% e respondentëve jetojnë në Deçan, 0.1% jetojnë në Dragash, 0.1% në Drenas, 0.4% në Fushë Kosovë, 6.7% në Gjakovë, 0.2% në Gjilan, 10.2% në Istog, 1.4% në Junik, 6.3% Klinë, 0.1% në Malishevë, 0.1% në Obiliq, 58.8% në Pejë, 1.3% në Pejë, 0.4% në Prizren, 0.1% në Shtime, 0.2% në Skënderaj dhe 1.1% e respondentëve jetojnë jashtë Kosovës, në shtetet si: Gjermania (përkatësisht në Hanover, München, Stuttgart), Suedia dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës (SHBA), përkatësisht në New York.

Tabela 4. Fakultetet në të cilat kanë ndjekur studimet respondentët

Fakulteti	Frekuenca	Përqindja	Përqindja Valide	Përqindja Kumulative
Fakulteti i Biznesit	548	54.7	54.7	54.7
Fakulteti Juridik	242	24.2	24.2	78.8
Fakulteti i Menaxhimit në Turizëm, Hoteleri dhe Mjedis	129	12.9	12.9	91.7
Fakulteti i Agrobiznesit	58	5.8	5.8	97.5
Fakulteti i Arteve	25	2.5	2.5	100.0
Totali	1002	100.0	100.0	

Grafiku 3. Fakultetet në të cilat kanë ndjekur studimet respondentët



Në Tabelën 4 dhe Grafikon 3 paraqiten rezultatet lidhur me fakultetet ku kanë ndjekur studimet të diplomuarit e UHZ-së dhe siç shihet 54.7% e të diplomuarve të UHZ-së kanë ndjekur studimet në Fakultetin e Biznesit, 24.2% në Fakultetin Juridik, 12.9% në Fakultetin e Menaxhimit në Turizëm, Hoteleri dhe Mjedis, 5.8% në Fakultetin e Agrobiznesit dhe 2.5% Fakultetin e Arteve.

Ndërsa në Tabelën 5 dhe Grafikon 4 paraqiten rezultatet lidhur me departamentet në të cilat kanë studiuar të diplomuarit e UHZ-së. Këto rezultate tregojnë se 22.0% e të diplomuarve kanë studiuar në departamentin Administrim Biznesi, 20.7% në departamentin Kontabilitet dhe Financa, 1.5% në departamentin Administrim Biznesi - Gjuhë Boshnjake, 2.9% në departamentin Menaxhim Biznesi, 0.3% në departamentin Banka dhe Financa, 0.1% në departamentin Menaxhim Biznesi - Gjuhë Boshnjake, 3.5% në departamentin Menaxhim i Burimeve Njerëzore, 1.1% në departamentin Informatikë e Aplikuar në Biznes, 21.4% në departamentin Juridik i Përgjithshëm, 1.9% në departamentin Juridiko - Penal, 0.9% në departamentin Administrativ Kushtetues, 0.1% në departamentin E Drejta Ndërkombëtare dhe Evropiane, 12.2% në departamentin Menaxhim në Turizëm dhe Hoteleri, 0.8% në departamentin Menaxhim i Mjedisit, 3.1% në departamentin Teknologji Ushqimore, 1.3% në departamentin Teknologjia e Prodhimit Bimor, 1.3% në departamentin Agromjedis dhe Agroekologji, 0.6% në departamentin Edukim Artistik në Instrumente Frymore, 1.5% në departamentin Edukim i Përgjithshëm në Muzikë dhe 0.1% në departamentin Regji film dhe Tv (shih Tabela 5 dhe Grafiku 4).



Tabela 5. Departamentet në të cilat kanë ndjekur studimet respondentët

Departamentet	Frekuenca	Përqindja
Administrim Biznesi	220	22.0
Kontabilitet dhe Financa	207	20.7
Administrim Biznesi - Gjuhë Boshnjake	15	1.5
Menaxhim Biznesi	29	2.9
Banka dhe Financa	3	.3
Menaxhim Biznesi - Gjuhë Boshnjake	1	.1
Menaxhim i Burimeve Njerëzore	35	3.5
Informatikë e Aplikuar në Biznes	11	1.1
Juridik i Përgjithshëm	214	21.4
Juridiko - Penal	19	1.9
Administrativ Kushtetues	9	.9
E Drejta Ndërkombëtare dhe Evropiane	1	.1
Menaxhim në Turizëm dhe Hoteleri	122	12.2
Menaxhim i Mjedisit	8	.8
Teknologji Ushqimore	31	3.1
Teknologjia e Prodhimit Bimor	13	1.3
Agromjedis dhe Agroekologji	13	1.3
Edukim Artistik në Instrumente Frymore	6	.6
Edukim i Përgjithshëm në Muzikë	15	1.5
Regji film dhe Tv	1	.1
Totali	973	97.1
Mungojnë të dhënat	29	2.9
Totali i përgjithshëm	1002	100.0



Grafiku 4. Departamentet në të cilat kanë ndjekur studimet respondentët







Tabela 6. Niveli i studimeve të respondentëve

Niveli i studimeve	Frekuenca	Përqindja	Përqindja Valide	Përqindja Kumulative
Bachelor	622	62.1	62.1	62.1
Master	380	37.9	37.9	100.0
Totali	1002	100.0	100.0	

Grafiku 5. Niveli i studimeve të respondentëve



Nga rezultatet e shfaqura në Tabelën 6 dhe Grafikon 5 shihet se 62.1% e respondentëve kanë përfunduar studimet e nivelit bachelor në UHZ dhe 37.9% kanë përfunduar studimet e nivelit master në UHZ.

Në Tabelën 7 dhe Grafikon 6 paraqiten rezultatet për vitet e diplomimit të respondentëve. Një pjesë e respondentëve (3.3%) kanë diplomuar në intervalin e viteve 2000 - 2011, pra kur ishte aktiv FSHAB, i cili funksiononte nën UP. Siç e dimë, UHZ si IAL është themeluar më 14.11.2011, por procesi mësimor ka filluar më 01.10.2012. Nga ky vit, pra nga viti 2012, UHZ ka lëshuar diploma si IAL i pavarur që do të thotë se menjëherë prej vitit 2012 UP i ka bartur kompetencat UHZ-së që të inicoj diploma. Lidhur me këtë nga rezultatet shihet se, 2.2% e respondentëve kanë diplomuar në vitin 2012, 2.5% kanë diplomuar në vitin 2013, 6.6% kanë diplomuar në vitin 2014, 5.9% e respondentëve kanë diplomuar në vitin 2015,



7.5% në vitin 2016, 6.6% në vitin 2017, 8.5% në vitin 2018, 15.4% në vitin 2019, 19.6% në vitin 2020, 10.9% në vitin 2021, 6.4% në vitin 2022 dhe 1.1% në vitin 2023.

Tabela 7. Vitet e diplomimit të respondentëve

Viti i diplomimit	Frekuenca	Përqindja
2000-2011	33	3.3
2012	22	2.2
2013	25	2.5
2014	66	6.6
2015	59	5.9
2016	75	7.5
2017	66	6.6
2018	85	8.5
2019	154	15.4
2020	196	19.6
2021	109	10.9
2022	64	6.4
2023	11	1.1
Totali	965	96.3
Mungojnë të dhënat	37	3.7
Totali i përgjithshëm	1002	100

Grafiku 6. Vitet e diplomimit të respondentëve




Tabela 8. Niveli i punësimit të respondentëve

I/e punësuar	Frekuenca	Përqindja	Përqindja Valide	Përqindja Kumulative
Po	646	64.5	64.5	64.5
Jo	356	35.5	35.5	100.0
Totali	1002	100.0	100.0	

Tabela 9. Niveli i vetëpunësimit të respondentëve

I/e vetëpunësuar	Frekuenca	Përqindja	Përqindja Valide	Përqindja Kumulative
Po	29	2.9	2.9	2.9
Jo	973	97.1	97.1	100.0
Totali	1002	100.0	100.0	

Grafiku 7. Niveli i punësimit dhe i vetëpunësimit të respondentëve




Tabela 8, Tabela 9 dhe Grafiku 7 japin rezultatet lidhur me punësimin dhe vetëpunësimin e respondentëve. Më saktësisht, nga Tabela 8 shihet se 64.5% e respondentëve janë të punësuar dhe 35.5% e tyre janë të papunësuar. Ndërsa nga Tabela 9 shihet se 2.9% e respondentëve janë të vetëpunësuar dhe 97.1% nuk janë të vetëpunësuar.

Tabela 10. Kryqëzimi i tabelave të nivelit të punësimit dhe të vetëpunësimit i respondentëve

			I/e vetëpunësuar		Totali
			Po	Jo	
I/e punësuar	Po	Frekuenca	7	639	646
		Përqindja	0.7%	63.8%	64.5%
	Jo	Frekuenca	22	334	356
		Përqindja	2.2%	33.3%	35.5%
Totali		Frekuenca	29	973	1002
		Përqindja	2.9%	97.1%	100.0%

Pasiqë u paraqitën raste kur respondentët deklarorin se janë edhe të punësuar edhe të vetëpunësuar, për të marrë rezultate akoma më të detajuara është bërë kryqëzimi i tabelave (shih Tabela 10) të nivelit të punësimit dhe të vetëpunësimit të respondentëve. Nga rezultati i dalë vërehet se në 0.7% të rasteve respondentët kanë deklaruar se janë edhe të punësuar edhe të vetëpunësuar, në 63.8% të rasteve respondentët kanë deklaruar se janë vetëm të punësuar, në 2.2% të rasteve ata kanë deklaruar se janë vetëm të vetëpunësuar dhe në 33.3% të rasteve kanë deklaruar se nuk janë as të punësuar dhe as të vetëpunësuar. Rezultatet në Tabelën 10 ndërlihen drejtpërdrejt me rezultatet në Tabelat 8 dhe 9 pasi që totali në të dyja rastet, sikur tek niveli i punësimit ashtu edhe tek niveli i vetëpunësimit, korrespondon në të gjitha tabelat.

Tabela 11. Niveli i punësimit sipas nivelit të shkollimit

	Numri i të punësuarve	Përqindja e punësimit
Pa shkollë	950	3.3
Shkollim fillor	45,731	11.3
Arsim i mesëm profesional	109,157	37.1
Arsim i mesëm - Gjimnazi	98,113	32.9
Terciar	129,353	62.6
Totali	383,304	31.1

Burimi: ASK (2022)

Sipas raportit të fundit të ASK-së për "Anketën e Fuqisë Punëtore 2021", të publikuar në Dhjetor 2022, mund të kuptohet se niveli i përgjithshëm i punësimit në Kosovë është 31.1%, apo shprehur në numra nominal numri total i të punësuarve në Kosovë është 383,304 (shih Tabela 11). Vlenë të ceket se



62.6% e të punësuarve kanë të përfunduar nivelin terciar të shkollimit, të njohur ndryshe si arsimit i lartë. Nga kjo kuptohet qartë se sa më i lartë niveli i shkollimit aq më i lartë është punësimi.

Tabela 12. Niveli i punësimit sipas llojit të sektorit

	Sektori Publik, Qeveria	Ndërmarrje në Pronësi Shtetërore	Kompani ose Ndërmarrje Private	Ndërmarrje Individuale Private
Pa shkollë	0.2	0.8	0.1	0.8
Shkollim fillor	3.0	7.3	12.5	48.8
Arsim i mesëm profesional	18.4	26.3	30.5	20.7
Arsim i mesëm - Gjimnazi	14.1	16.1	30.6	24.6
Terciar	64.3	49.5	26.2	5.1
Totali	100.0	100.0	100.0	100.0

Burimi: ASK (2022)

Sipas të njëjtin raport, të cituar më lartë, nëse i referohemi arsimit të lartë shihete se në 64.3% të rasteve personat që kanë përfunduar nivel të tillë arsimor janë të punësuar në sektorin publik, në 49.5% të rasteve ata janë të punësuar në ndërmarrje me pronësi shtetërore, në 26.2% të rasteve në kompani ose ndërmarrje private dhe në 5.1% të rasteve në ndërmarrje individuale private (shih Tabela 12).

Tabela 13. Statusi i punësimit sipas kategorive

Kategoritë	Statusi i punësimit	Statusi i punësimit (në përqindje)
Punonjës	299.033	78.0
I vetëpunësuar me punonjës	35.513	9.3
I vetëpunësuar pa punonjës	37.625	9.8
Punëtor familjar i papaguar	11.133	2.9
Totali	383.304	100.0

Burimi: ASK (2022)


Sa i përket kategorive të punësimit, sipas ASK-së, 78.0% e të punësuarve janë në rolin e punonjësit, 9.3% janë të vetëpunësuar me punonjës, 9.8% janë të vetëpunësuar pa punonjës dhe 2.9% janë punëtorë familjar të papaguar.



Tabela 14. Kategoritë e institucioneve dhe bizneseve ku janë të punësuar të diplomuarit e UHZ-së

Nr.	Kategoria e Biznesit	Frekuenca	Përqindja
1	Universiteti "Haxhi Zeka" - Pejë	36	3.6
2	IAL të Tjera	3	0.3
3	Institucione Arsimore (përveç IAL-ve)	30	3
4	Ministri të Ndryshme	13	1.3
5	Komunë	57	5.7
6	Agjenci të Ndryshme	16	1.6
7	Institute të Ndryshme	4	0.4
8	Institucione Bankare dhe Institucione Mikrofinanciare	37	3.7
9	Prokuroria dhe Gjykata Themelore - Pejë	15	1.5
10	Policia e Kosovës	22	2.2
11	Forca e Sigurisë Së Kosovës (FSK)	4	0.4
12	Dogana e Kosovës	1	0.1
13	Autoriteti i Konkurrencës së Republikës së Kosovës (AKK)	1	0.1
14	Institucioni i Avokatit të Popullit	1	0.1
15	Shërbimi Korrektues i Kosovës (SHKK)	5	0.5
16	SHA Infrakos	1	0.1
17	Posta e Kosovës dhe Telekomit i Kosovës SHA	8	0.8
18	KEDS	1	0.1
19	Shërbime Avokature, Kontabiliteti dhe Auditimi	12	1.2
20	Qendra të Shërbimeve Shëndetësore dhe Biznese Farmaceutike	20	2
21	Organizata Joqeveritare	11	1.1
22	Qendra Tregtare	64	6.4
23	Qendra Konsulence	7	0.7
24	Qendra të Thirrjeve	12	1.2
25	Kompani të Sigurimeve	5	0.5
26	Agjencione Turistike	8	0.8
27	Restaurante dhe Hotele	15	1.5
28	Kompani Rajonale të Mbeturave dhe të Ujësjellësit	13	1.3
29	Fabrika dhe Ndërmarrje Prodhuese	31	3.1
30	Ndërmarrje Tregtare	53	5.3
31	Ndërmarrje/Biznese Shërbyese	32	3.2
32	Ndërmarrje Tregtare dhe Prodhuese	4	0.4
33	Ndërmarrje Tregtare dhe Shërbyese	10	1
34	Ndërmarrje/Kompani Distribucioni	14	1.4
35	Kompani Ndërtimi	7	0.7
36	Të tjera	48	4.8
37	Biznese Jashtë Kosovës	11	1.1
	Mungojnë të dhënat	370	36.9
	Totali	1002	100.0

Grafiku 8. Kategoritë e institucioneve dhe bizneseve ku janë të punësuar të diplomuarit e UHZ-së



Bazuar në rezultatet e paraqitura në Tabelën 14 dhe Grafikon 8 kuptohen kategoritë e institucioneve dhe bizneseve ku janë të punësuar të diplomuarit e UHZ-së. Nga këto rezultate shihet se:

- 3.6% e të diplomuarve të UHZ-së janë të punësuar në UHZ;
- 0.3% janë të punësuar në IAL të tjera, ku përfshihen Universiteti "Fehmi Agani" - Gjakovë dhe Kolegji AAB;



- 3.0% janë të punësuar në institucione arsimore (përveç IAL-ve), ku përfshihen shkollat e mesme, fillore dhe çerdhet;
- 1.3% janë të punësuar nëpër ministri të ndryshme si Ministria e Drejtësisë, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Ministria e Punëve të Brendshme dhe Ministria e Shëndetësisë;
- 5.7% janë të punësuar nëpër Komuna, ku përfshihen Komuna e Pejës, Istogut, Deçanit, Klinës, Gjakovës, Junikut dhe vendpunimet si Administrata Komunale, Administrata Pensionale, Drejtoria e Urbanizimit, Drejtoria e Arsimit, Drejtoria për Mirëqenie Sociale, Zyra e Punësimit, Zyra e Tatimit në Pronë, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, dhe Qendra për Punë Sociale;
- 1.6% janë të punësuar në agjenci të ndryshme si Agjencia e Pyjeve të Kosovës (APK), Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP), Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit (APK), Agjencia Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës (AKKVP), Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), Agjencia e Menaxhimit Emergjent 112 dhe Agjenci për Ndihmë Juridike Falas;
- 0.4% janë të punësuar në institute të ndryshme si Instituti Bujqësor i Kosovës, Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) dhe Instituti i Shëndetit Publik (ISHP);
- 3.7% janë të punësuar në institucione bankare, ku përfshihen Banka Ekonomike, Banka Kombëtare Tregtare (BKT), Banka për Biznes (BPB), NLB Banka, Raiffeisen Bank dhe TEB SHA, dhe institucione mikrofinanciare ku përfshihen FINCA, Kreditimi Rural i Kosovës (KRK) dhe KEP;
- 1.5% janë të punësuar në Prokurorinë Themelore dhe në Gjykatën Themelore në Pejë;
- 2.2% janë të punësuar në Policinë e Kosovës;
- 0.4% janë të punësuar në Forcën e Sigurisë së Kosovës (FSK);
- 0.1% janë të punësuar në Doganën e Kosovës;
- 0.1% janë të punësuar në Autoritetin e Konkurrencës së Republikës së Kosovës (AKK);
- 0.1% janë të punësuar në Institucionin e Avokatit të Popullit;
- 0.5% janë të punësuar në Shërbimin Korrektues të Kosovës (SHKK);
- 0.1% janë të punësuar në SHA Infracos;
- 0.8% janë të punësuar në Postën e Kosovës dhe në Telekomin e Kosovës;
- 0.1% janë të punësuar në KEDS;
- 1.2% janë të punësuar nëpër zyra që ofrojnë shërbime avokature, kontabiliteti dhe auditimi;



- 2.0% janë të punësuar në qendra që ofrojnë shërbimeve shëndetësore dhe në biznese farmaceutike;
- 1.1% janë të punësuar në OJQ të ndryshme;
- 6.4% janë të punësuar nëpër qendra tregtare si ETC, Elkos Center, Express Store, Viva Fresh Store, Interex, A&M Mega Store, Ideal Center, Liridoni NT, Nora Market, Rina Market, Deppo Market, Market "Luani" dhe të ngjashme;
- 0.7% janë të punësuar nëpër qendra të konsulencës;
- 1.2% janë të punësuar nëpër qendra të ndryshme të thirrjeve;
- 0.5% janë të punësuar në kompani të sigurimeve;
- 0.8% janë të punësuar në agjencione turistike;
- 1.5% janë të punësuar në restorante dhe hotele të ndryshme;
- 1.3% janë të punësuar në Kompani Rajonale të Mbeturinave (KRM) dhe në Kompani Rajonale të Ujësllësit (KRU);
- 3.1% janë të punësuar në fabrika, ku përfshihen Fabrika "Ujë Rugove", Fabrika e Ujit "Spirit of Drini", Fabrika e Miellit "M&Silloso", Fabrika e Detergjentëve "Jonal", Fabrika "Amo Foods" dhe Fabrika e Mobileve "Mobile Karagaq", dhe ndërmarrje prodhuese, ku përfshihen Ndërmarrja Prodhuese "Birra Peja", Devolli Corporation, Sedefi Commerce, Sharrcem, Sinalco, Fresh-Co, Kamila SHPK, Joos&Krasniqi, Green House SHPK dhe të ngjashme;
- 5.3% janë të punësuar nëpër ndërmarrje tregtare si Neptun, Jysk, ROSSMAN, Gogaj AG, LC Waikiki, Comodita Home, Gorenje Department Store, Alba Qeramika, mobileri tëndryshme, butiqe dhe të ngjashme;
- 3.2% janë të punësuar në ndërmarrje apo biznese shërbyese si Western Union, Biblioteka "Azem Shkreli", Ipko Telecommunication, Kujtesa, Teleperformance, Moneta Moneygram Kosovo, Monego, agjenci të ndryshme marketing, zyra noteri, këshilltar juridik dhe të ngjashme;
- 0.4% janë të punësuar në ndërmarrje tregtare dhe prodhuese;
- 1.0% janë të punësuar në ndërmarrje tregtare dhe shërbyese;
- 1.4% janë të punësuar në ndërmarrje apo kompani distribucioni si Buçaj SHPK, Buçaj SHPK, Elkos Group dhe Ideal Group;
- 0.7% janë të punësuar në kompani ndërtimi si Engineering IB SHA, Mirusha Company - Klinë, Kelmendi Group SHPK, Ndërmarrja "Armendi FA", Nezi Com dhe Interling Construction;
- 4.8% janë të punësuar në biznese të tjera, ku përfshihen biznese më të vogla; dhe




- 1.1% janë të punësuar në biznese jashtë Kosovës, ku përfshihen Scharifi GMBH, Lidl Vertriebs GMBH, McDonalds - München, Galären i Luleå AB - Suedi, Related - New York, STAHL, Studie Deutsch, Hallsberg Kommun dhe IMV Objektverwaltungs GMBH.

Tabela 15. Kategoritë e bizneseve ku janë vetëpunësuar të diplomuarit e UHZ-së

Biznesi vetëpunësuar	Frekuenca	Përqindja
Avokaturë	2	0.2
Zyrë Auditimi	1	0.1
Librari	2	0.2
Mobileri	1	0.1
OJQ	1	0.1
Biznese Familjar	2	0.2
Biznese Private	20	2
Totali	29	2.9

Grafiku 9. Kategoritë e bizneseve ku janë vetëpunësuar të diplomuarit e UHZ-së




Sa i përket bizneseve ku janë vetëpunësuar të diplomuarit e UHZ-së, rezultatet e Tabelës 15 dhe Grafikut 9 tregojnë se 0.2% e tyre kanë avokaturë të veten, 0.1% kanë zyrë auditimi, 0.2% librari, 0.1% mobileri, 0.1% OJQ, 0.2% kanë hapur biznese familjare dhe 2.0% kanë biznese private individuale.



Tabela 16. Rolet apo pozitat që kanë të diplomuarit e UHZ-së në vendet e tyre të punës

Roli Pozita	Frekuenca	Përqindja
Profesor/Ligjërues/Mësimdhënës/Edukator	19	1.9
Menaxher	56	5.6
Udhëheqës/Shef/Kryeshef Ekzekutiv	14	1.4
Drejtor	21	2.1
Zyrtar	86	8.6
Asistent	21	2.1
Avokat/Jurist/Auditor/Kontabilist	19	1.9
Sekretar	2	0.2
Mbikëqyrës/Përgjegjës	9	0.9
Këshilltar/Koordinator/Administrator	11	1.1
Ekonomist/Financier	5	0.5
Faturist/Kalkulant	4	0.4
Anketues/Intervistues/Hulumtues/Gazetar	8	0.8
Analist	9	0.9
Agjent	15	1.5
Asambleist	2	0.2
Referent i Lartë	1	0.1
Pronar/Punëdhënës	9	0.9
Punonjës Operativë në Biznese	54	5.4
Punonjës Operativë në Hotele dhe Restorante	9	0.9
Inspektor i Tregut	1	0.1
Regjisor	1	0.1
Staf Policor	8	0.8
Praktikant	8	0.8
Infermier	2	0.2
Teknik i Farmacisë	2	0.2
Tjetër	23	2.3
Mungojnë të dhënat	583	58.2
Total	1002	100

Grafiku 10. Rolet apo pozitat që kanë të diplomuarit e UHZ-së në vendet e tyre të punës



Lidhur me rolet apo pozitat që kanë të diplomuarit e UHZ-së në vendet e tyre të punës paraqiten rezultatet në Tabelën 16 dhe Grafikon 10. Ka rezultuar se:

- 1.9% e të diplomuarve të UHZ-së janë profesorë, prodekanë, ligjërues, mësimdhënës apo edukatorë;
- 5.6% janë menaxherë, ku përfshihen pozitat si menaxher gjeneral, menaxher departamenti, menaxher i burimeve njerëzore, menaxher i cilësisë, menaxher i import/eksportit, menaxher i rrjeteve sociale, menaxher i programeve, menaxher regjional, menaxher sektori, menaxher në Policinë e Kosovës dhe të ngjashme;



- 1.4% janë në rolin e udhëheqësit/shefit/kryeshefit ekzekutiv, ku përfshihen rolet si udhëheqës grupi, udhëheqës i kontrollit financiar, udhëheqës i qendrës për biznese, udhëheqës i qendrës për regjistrimin e automjeteve, udhëheqës i sektorit për teknologji, udhëheqës i sektorit të tatimit në pronë, shef i gjendjes civile, shef i sektorit, shef i sektorit të turizmit dhe të ngjashme;
- 2.1% janë drejtorë, ku përfshihen pozitat si drejtor departamenti, drejtor i inspektoratit, drejtor i it, drejtor i shitjes, drejtor në divizionin e blerjeve, drejtor për buxhet dhe financa, drejtor për ekonomi dhe zhvillim, drejtor për mësimdhënie dhe çështje akademike dhe UD drejtor;
- 8.6% janë zyrtarë, ku përfshihen pozitat si zyrtar administrativ, zyrtar i asistencës sociale, zyrtar i burimeve njerëzore, zyrtar i financave, zyrtar i gjendjes civile, zyrtar i lartë, zyrtar i pagave, zyrtar i prokurimit, zyrtar i shërbimit social, zyrtar i shërbimit të studentëve, zyrtar i shitjes, zyrtar i të hyrave, zyrtar korrektures, zyrtar ligjor, zyrtar për zhvillim të karrierës, zyrtar për buxhet dhe financa, zyrtar për çështje studentore, zyrtar për dokumente të prokurorëve, zyrtar për informim dhe bashkëpunim, zyrtar për inkasim, zyrtar për kulturë, zyrtar për marrëdhënie me publikun, zyrtar për mirëmbajtje të rrjetit, zyrtar për pensione, zyrtar për përkujdesje për konsumatorë, zyrtar për planifikim dhe zhvillim, zyrtar për projekte, zyrtar për shërbim të qytetarëve, zyrtar për vlerësim të pronave të paluajtshme, zyrtar për zotimin e mjeteve buxhetore, zyrtar policor, zyrtar rajonal dhe zyrtar sprovues;
- 2.1% janë asistentë, ku përfshihen rolet si asistent administrativ, asistent i auditimit, asistent i kontabilitetit, asistent ekzekutiv, asistent i angazhuar, asistent i kryesuesit, asistent i shitjes, asistent në financa dhe asistente e rektorit;
- 1.9% janë avokatë, juristë, auditorë apo kontabilistë;
- 0.2% janë në rolin e sekretarit, ku përfshihet edhe roli i sekretarit të njësisë akademike;
- 0.9% janë në rolin e mbikëqyrësit ose përgjegjësit, ku përfshihen pozitat si Mbikëqyrës i Hetimeve Kundër Trafikimit të Njerëzve, Mbikëqyrës i Prodhimit, Mbikëqyrës i Punëtorëve, Përgjegjës i Pikës, Përgjegjës i Sektorit, Përgjegjës për Hulumtimin e Tregut dhe Çështjet Financiare dhe Përgjegjës për Statistikat e Hotelerisë;
- 1.1% janë në rolin e këshilltarit, koordinatorit ose administratorit;
- 0.5% janë economist ose financier;
- 0.4% janë futurist ose kalkulant;
- 0.8% janë anketues, intervistues, hulumtues ose gazetar;
- 0.9% janë në rolin e analistit, ku përfshihen pozitat si analist kreditor dhe analist për biznese;




- 1.5% janë në rolin e agjentit, ku përfshihen pozitat si agjent i shitjes dhe agjent i thirrjeve;
- 0.2% janë asambleist;
- 0.1% janë në rolin e referentit të lartë;
- 0.9% janë pronarë apo punëdhënës;
- 5.4% janë punonjës operativë në biznese, ku përfshihen pozitat si arkatar, shitës, depoist dhe sektorist;
- 0.9% janë punonjës operativë në restorante dhe hotele, ku përfshihen pozitat si recepcionist, shankist, kamarier dhe kuzhinier;
- 0.1% janë në rolin e inspektorit të tregut;
- 0.1% janë në rolin e regjisorit;
- 0.8% janë staf policor, ku përfshihen rolet si polic, polic i lartë, rreshter, toger i policisë - shef i njësisë kundër drogave dhe hetues;
- 0.8% janë praktikant ose praktikant me pagesë;
- 0.2% janë infermier ose kryeinfermier;
- 0.2% janë teknikë të farmacisë; dhe
- 2.3% kanë role apo pozita të tjera si bashkëpunëtor i jashtëm, bashkëpunëtor profesional, broker, monitorues ligjor - avokat i komuniteteve, operator, drejtues i lëvizjes së trenave, freelancer (punonjës i pavarur), kryepunëtor, sigurim/roje, furnizues importi, inkasant dhe të ngjashme.

Tabela 17. Sa iu kanë shërbyer njohuritë e fituara gjatë studimeve në punën tuaj?

	Frekuenca	Përqindja	Përqindja Valide	Përqindja Kumulative
Aspak	28	2.8	4.2	4.2
Pak	83	8.3	12.5	16.7
Mesatarisht	122	12.2	18.4	35.1
Mjaftueshëm	189	18.9	28.5	63.7
Shumë	241	24.1	36.3	100.0
Total	663	66.2	100.0	
Mungojnë të dhënat	339	33.8		
Total	1002	100.0		



Grafiku 11. Sa iu kanë shërbyer njohuritë e fituara gjatë studimeve në punën tuaj?



Kur të diplomuarit e UHZ-së, apo thënë ndryshe respondentët, u pyetën se “Sa iu kanë shërbyer njohuritë e fituara gjatë studimeve në punën tuaj?”, 2.8% e tyre u përgjigjën me “aspak”, 8.3% u përgjigjën me “pak”, 12.2% me “mesatarisht”, 18.9% me “mjaftueshëm” dhe 24.1% me “shumë”.



5. KONKLuzionet dhe Rekomandimet

Universiteti "Haxhi Zeka" në Pejë është Institucion i Arsimit të Lartë i themeluar në vitin 2011, në kuadër të të cilin funksionojnë pesë (5) fakultete, Pa dyshin se si IAL, qëllimi kryesor i tij është përgatitja e kuadrove të reja dhe profesionale në fushat përkatëse. Në kuadër të UHZ-së funksionon Zyra për Zhvillim të Karrierës, me objektivin kryesor orientimin dhe këshillimin e studentëve për qasje sa më të mirë në tregun e punës, e cila në bashkëpunim me Shoqatën e të diplomuarve ALUMNI - UNHZ kanë realizuar studimin lidhur me punësueshmërinë e të diplomuarve të UHZ-së.

Nga ky studim i realizuar mund të konkludohet se 64.5% e të diplomuarve të UHZ-së janë të punësuar dhe 35.5% e tyre janë të papunësuar. Po ashtu, 2.9% e të diplomuarve të UHZ-së janë të vetëpunësuar. Nga rezultatet ka dalë se në 0.7% të rasteve të diplomuarit e UHZ-së kanë deklaruar se janë edhe të punësuar edhe të vetëpunësuar, në 63.8% të rasteve ata kanë deklaruar se janë vetëm të punësuar, në 2.2% të rasteve kanë deklaruar se janë vetëm të vetëpunësuar dhe në 33.3% të rasteve kanë deklaruar se nuk janë as të punësuar dhe as të vetëpunësuar.

Në anën tjetër, sipas raportimeve të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, niveli i përgjithshëm i punësimit në Kosovë është 31.1%. Nga këta, 62.6% e të punësuarve kanë të përfunduar nivelin e lartë të arsimit. Nga këto rezultate dhe nga të gjetura shihet qartë një ndërlidhje ndërmjet nivelit të punësimit të të diplomuarve të UHZ-së dhe të të punësuarve në përgjithësi dhe vërtetohet se sa më i lartë niveli i shkollimit aq më i lartë është niveli i punësimit.

Të diplomuarit e UHZ-së janë të punësuar në institucione dhe biznese të ndryshme, përfshirë Institucionet e Arsimit të Lartë, Ministrinë, Agjencitë, Institutet, Komunat, Prokurorinë dhe Gjykatën Themelore, Policinë e Kosovës, Forcën e Sigurisë së Kosovës, Autoritetin e Konkurrencës së Republikës së Kosovës, Institucionin e Avokatit të Popullit, Institucionet Financiare dhe Mikrofinanciare, ndërmarrjet në pronësi shtetërore, ndërmarrjet private prodhuese, shërbyese dhe tregatë, organizatat joqeveritare dhe të ngjashme.

Sa i përket roleve apo pozitive të tyre themi se të diplomuarve të UHZ-së ushtrojnë profesione si: profesorë, prodekanë, ligjërues, meaxherë, udhëheqës, kryeshef ekzekutiv, drejtorë, zyrtarë, asistentë, avokatë, juristë, auditorë, kontabilistë, sekretarë, mbikëqyrës, këshilltar, koordinator, administrator, ekonomist, kalkulant, anketues, intervistues, hulumtues, analistë, agjentë, asambleistë, referentë,



pronarë biznesesh, punonjës operativë, inspektorë, regjisorë, policë, praktikantë, bashkëpunëtor i jashtëm, bashkëpunëtor profesional, punonjës i pavarur, kryepunëtor, furnizues importi dhe të ngjashme.

Lidhur me aspektin se sa iu kanë shërbyer në punë njohuritë e fituara gjatë studimeve, konkludohet se shumicës së të diplomuarve njohuritë e marra nga studimet iu kanë shërbyer pozitivisht në punën e tyre dhe iu kanë mundësuar ngritje më të shpejtë në pozita. Kjo jep një rezultat pozitiv për punën dhe angazhimin e UHZ-së në përgatitjen e kuadrove të reja për tregun e punës.

Nga komentet e të diplomuarve është mundësuar të bëhet një përmbledhje lidhur me përshtypjet e tyre pas përfundimit të studimeve. Lidhur me këtë konkludohet se:

- Të diplomuarit e UHZ-së në përgjithësi janë të kënaqur me studimet që kanë ndjekur,
- Njohuritë e fituara nga studimet i konsiderojnë si pjesë të rëndësishme të formimit të tyre akademik,
- Studimet e ndjekura në UHZ kanë hapur dyert e karrierës për shumë prej tyre,
- Një pjesë e madhe e atyre që kanë përfunduar studimet e nivelit bachelor kanë vazhduar studimet edhe në nivelin master në UHZ,
- Të diplomuarit e UHZ-së, suksesin e tyre në karrierë iu atribuojnë këtij institucioni,
- Programet e studimit janë të adekuate me çka kërkohet në tregun e punës,
- Atyre të cilët ishin të punësuar para diplomimit, marrja e diplomës në UHZ iu ka mundësuar ngritje në detyrë,
- UHZ ofron të gjitha mundësitë për përfitimin e njohurive shkencore,
- Diplomat e UHZ-së njihen edhe në shtetet e jashtme gjë të iu ka mundësuar të diplomuarve të UHZ-së të punësohen në profesionet e tyre dhe të jenë të barabartë me të diplomuarit jashtë Kosovës.

Në mënyrë të përmbledhur, mund të thuhet se të diplomuarit e UHZ-së janë të kënaqur me përgatitjen e tyre profesionale gjatë studimeve në UHZ dhe për këtë i janë me të vërtetë mirënjohës institucionit dhe stafit të UHZ-së në tërësi për njohuritë e fituara dhe për përgatitjen profesionale.



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET

"HAXHI ZEKA"

Shoqata ALUMNI - UNHZ
Pejë



Gjithashtu, nga të diplomuarit e UHZ-së janë marrë edhe rekomandime se si UHZ të performoj akoma më mirë dhe për studentët e vetë të ofroj më të mirën. Rekomandimet e tilla përmblihen si vijon:

- Të ofrohen më shumë mundësi për punë praktike gjatë studimeve,
- Të organizohen më shumë vizita studentore në Universitete të tjera brenda dhe jashtë Kosovës me qëllim të shkëmbimit të përvojave,
- Studentëve t'iu ofrohet qasje përmes institucionit në literaturë të huaj të viteve të fundit,
- Të ofrohen mundësi më të shumta për kyçjen e studentëve në analiza dhe hulumtime shkencore,
- Të organizohen tryeza më të shpeshta diskutimi lidhur me çështjet me të cilat preokupohet tregu kosovar dhe ai botëror dhe
- Të organizohen aktivitete më të shpeshta të Shoqatës ALUMNI - UNHZ, pra të shtohet angazhimi i kësaj shoqate me qëllim të zgjerimit të rrjetit të të diplomuarve dhe të bashkëpunimit ndërmjet Universitetit dhe të diplomuarve.



Referencat

1. ASK (2022). Seria 5: Statistikat Sociale - Anketa e Fuqisë Punëtore 2021. Prishtinë: Agjencia e Statistikëve të Kosovës. Marrë nga: <https://ask.rks-gov.net/media/7218/tregu-i-punes-2021.pdf>
2. Bethlehem, J. (2009). *Applied Survey Methods: A Statistical Perspective*. Hoboken, New Jersey: John Wiley & Sons, Inc.
3. Certo, S. C., & Certo, T. S. (2016). *Modern Management: Concepts and Skills* (14th Ed.). USA: Pearson.
4. David, F. R., & David, F. R. (2017). *Strategic Management: A Competitive Advantage Approach, Concepts and Cases* (16th Ed., Global Edition). Harlow, England: Pearson education Limited.
5. EU (2021). *The PM² Project Management Methodology Guide 3.0.1*. Luxembourg: Publications Office of the European Union.
6. Kopp, C. M. (2022, October 29). *Program Evaluation Review Technique (PERT) Chart Explained*. Investopedia. <https://www.investopedia.com/terms/p/pert-chart.asp>
7. Makela, J. P., Seo, G., Sun, H., & Rooney, G. S. (2014). *The Value of Using Career Services: A Comparison of Users and Non-Users*. The Career Center, University of Illinois at Urbana-Champaign. <https://www.careercenter.illinois.edu/sites/default/files/downloads/NASPARReport-Value-FINAL.pdf>
8. Polson, C. (2003). Adult Graduate Students Challenge Institutions to Change. *New Directions for Student Services*, 2003(102), 59-68. <https://doi.org/10.1002/ss.90>
9. Robbins, S., & Coulter, M. (2018). *Management* (14th Ed.). USA: Pearson.
10. Rothaermel, F. T. (2017). *Strategic Management* (3rd Ed.). New York: McGraw-Hill Education.
11. Song, Y. S. (2007). Collaboration with the Business Career Services Office: A case study at the University of Illinois at Urbana-Champaign. *Research Strategies*, 20(4), 311-321. <https://doi.org/10.1016/j.resstr.2006.12.006>
12. UNHZ (2013). *Statuti i Universitetit "Haxhi Zeka" - Pejë*. <https://unhz.eu/rregullore-2/#1675944577800-c31edf14-7439>
13. UNHZ (2023). *Plani Strategjik 2023-2026*. <https://unhz.eu/rregullore-2/#1675945312845-28d2fb45-a0f7>
14. Web Faqja Zyrtare e Universitetit "Haxhi Zeka" - Pejë: <https://unhz.eu/>

**SHTOJCË****Pyetësor për të diplomuarit e UHZ**

Ky pyetësor do të përdoret vetëm për qëllim të zgjerimit të rrjetit të të diplomuarve (ALUMNI - UNHZ) dhe për statistika të Universitetit "Haxhi Zeka" - Pejë (UHZ). Të dhënat tuaja janë konfidenciale.

Të dhënat personale

1.	Emri (Emri i Prindit) Mbiemri:	
2.	Gjinia:	<input type="checkbox"/> M <input type="checkbox"/> F
3.	Vendbanimi / Komuna:	
4.	Detajet kontaktuese:	Tel: Email:

Edukimi:

5.	Fakulteti / Departamenti / Niveli i Studimeve:	<input type="checkbox"/> Fakulteti i Biznesit - Niveli: _____ Departamenti: _____ <input type="checkbox"/> Fakulteti Juridik - Niveli: _____ Departamenti: _____ <input type="checkbox"/> Fakulteti i Menaxhimit në Turizëm, Hoteleri dhe Mjedis Niveli: _____ Departamenti: _____ <input type="checkbox"/> Fakulteti i Agrobiznesit - Niveli: _____ Departamenti: _____ <input type="checkbox"/> Fakulteti i Arteve - Niveli: _____ Departamenti: _____
6.	Viti i diplomimit:	

Punësimi

7.	A jeni të punësuar?	<input type="checkbox"/> Po <input type="checkbox"/> Jo
8.	Nëse po, shënoni emrin e institucionit/biznesit dhe vitin e punësimit?	Emri i institucionit/biznesit: _____ ▪ Viti: _____ Vetëpunësim: _____ ▪ Viti: _____
9.	Pozita/roli juaj (p.sh. menaxher):	
10.	Sa iu kanë shërbyer njohuritë e fituara gjatë studimeve në punën tuaj?	<input type="checkbox"/> Aspak <input type="checkbox"/> Pak <input type="checkbox"/> Mesatarisht <input type="checkbox"/> Mjaftueshëm <input type="checkbox"/> Shumë

Komente shtesë:

JU FALEMINDERIT PËR KOHËN TUAJ!